

Fitim Bekteshi, MA¹

UDC:
327.88-027.511

DHUNA E GLOBALES DHE TERRORI NDËRKOMBËTARË SI PASOJË E ZHVILLIMIT TË GLOBALIZIMIT SI ALTËRNATIVË APO SFIDË E RREGULLIMIT GLOBAL

ГЛОБАЛНОТО НАСИЛСТВО И МЕЃУНАРОДНИОТ ТЕРОРИЗАМ КАКО ПОСЛЕДИЦА НА РАЗВИТОКОТ НА ГЛОБАЛИЗАЦИЈАТА КАКО АЛТЕРНАТИВА ИЛИ ПРЕДИЗВИК НА ГЛОБАЛНИОТ ПОРЕДОК

GLOBAL VIOLENCE AND INTERNATIONAL TERROR AS A RESULT OF DEVELOPMENT OF GLOBALIZATION AS AN ALTERNATIVE OR CHALLENGE OF GLOBAL ORDER

“Pain, tragedy and hate, sooner or later go. Goodness remembrance and love are eternal.”²

Abstract

History gave the chance to universalism but, today, faced with a global order without any alternative on the one hand and with drifting insurrectionary singularity, on the other hand, the concepts of freedom, democracy and human rights look terrible. They remain as the ghosts of universalism past. Universalism once produced a culture characterized by the concepts of transcendence, subjectivity, reality and representation. On the contrary, today's virtual global culture has replaced universal concepts with screens, networks, immanence, numbers, and the time space continuum without any depth. Ecological consequences of corporate control over natural resources that influence the potential

¹ Magjistër i shkencave për siguri dhe detektiv, Republika e Kosovës. Master of Security Science and detective, Republic of Kosovo.

² George BUS.

of the less developed countries to achieve sustainable development are another essential observation area for young individuals. Hardly can be found nowadays most controversial phenomenon than terrorism. It has been present in almost all ages, at all times and systems, but now size that is taking, rank it among the biggest problems facing mankind. Crime is smaller today, when millions of people suffer from hunger, poverty, housing and removal of the natural state of living and acting equal to the rules of society and human nature. Students need to be challenged to think about the threat that war may start because of unfair distribution of the limited resources of water and about how debt crises and policies of national development driven by market demands will affect the opportunities of realization of a human dignity and environmental sustainability of the planetary environment. But this issue remains to be studied precisely by subsequent generations of contemporary society.

Keywords: History, universalism, terror, international terrorism, faced with global regulation, no alternative, driving insurgents singularity, the concepts of freedom, democracy and human rights, ghosts of universalism past etc.

1. Kultura e sotme virtuale globale i ka zëvendësuar konceptet universale

Historia ia dha rastin universalizimit mirëpo, sot, i ballafaquar me rregullimin global pa asnjë alternativë, në njërën anë dhe me singularitet lëvizës rebelues, në anën tjetër, konceptet e lirisë, demokracisë dhe të drejtave të njeriut duken tmerrshëm. Ato mbesin si fantazma të së kaluarës së universalizimit. Universalizmi dikur prodhonte një kulturë të karakterizuar nga konceptet e transcendencës, subjektivitetit, realitetit dhe reprezentimit. Përkundrazi, kultura e sotme virtuale globale i ka zëvendësuar konceptet universale me ekrane, rrjete, imanencë, numra, dhe me kontinuumin kohor-hapësinor pa kurrfarë thellësie.³

Veprimi ndaj formave të terrorizmit shoqërohet pra me përmasat e luftës politike dhe është veçanërisht intensive në vendet më të zhvilluara të botës, që kanë qen të parat që njohën standardizimin e jetës politike, të krijuar nga zgjerimi progresiv i të drejtës së votës (që pas Luftës së Dytë Botërore, praktikisht do të jetë universale). Kjo do të

³ Jean Baudrillard "Articles":a 129d date Publishet; 12. 7. 2004. Nga frengjishtja në anglisht Francois Debrix. Nga anglishtja në shqip Artan Muhaxhiri. www.ctori.net/articles.aspx?id=435.

thotë që në të njëjtën masë me të cilën rritet numri i personave që merren me politikë, po aq rriten mundësitë e tensionit midis grupeve shoqërore dhe ideologjive politike.⁴

Në universalen ende kishte hapësirë për një referencë natyrore ndaj botës, trupit apo të kaluarës. Kishte një lloj të tensionit dialektik ose të lëvizjes kritike, e cila materialitetin e vet e gjeti në dhunën historike dhe revolucionare. Mirëpo, përjashtimi i këtij negativiteti kritik i hapi dyert për një formë tjetër të *dhunës-dhunës së* globale. Kjo dhunë e re karakterizohet me supremacinë e efikasitetit teknik dhe të pozitivitetit, organizimit total, qarkullimit integral dhe barazimit të të gjitha shkëmbimeve. Për më tepër, dhuna e globale i jep fund rolit social të intelektuales (ide kjo lidhur ngushtë me iluminizmin dhe universalizmin), por gjithashtu edhe rolit të aktivistit, fati i të cilit dikur ishte i lidhur me idetë e opozitës kritike dhe dhunës historike.⁵

2. Universalja ishte një ide një ide apo sfidë për të ardhmen

Kur ajo u realizua në formën e globale, u zhduk si ide, bëri vetë-vrasje dhe u shua si një fund në vete. Pasi njerëzimi është tash imanencë e vetes, pas marrjes së vendit të lënë zbrazët nga Zoti i vdekur, njerëzorja është bërë e vetnija formë e referencës dhe ajo është sovrane. Por, ky njerëzim më nuk ka asnjë mbarim. I çliruar nga armiqtë e vet të dikurshëm, njerëzimi tash duhet të krijojë armiq nga brenda, gjë që, në të vërtetë, prodhon një gamë të gjerë të metastazave jonjerëzore. Dhuna e globale vjen pikërisht prej këtu. Ajo është produkt i sistemit, i cili ndjek çdo formë të negativitetit dhe singularitetit, natyrisht duke përfshirë edhe vdekjen si formën më të fundme të singularitetit. Kjo është dhuna e një shoqërie ku konflikti është i ndaluar, ndërsa vdekja nuk është e lejuar. Është dhunë, e cila, në një kuptim, i jep fund vetë dhunës dhe tenton që të ndërtojë një botë ku çdo gjë që ka lidhje me natyroren duhet të zhduket (qoftë kjo me trupin, seksin, lindjen apo vdekjen). Në vend se ta quajmë dhunë globale, atë ne duhet ta emërtojmë virulencë globale. Kjo formë e dhunës është me të vërtetë virale. Ajo përhapet si sëmundje ngjitëse, vazhdon me reaksion zinxhiror dhe dalëngadalë i shkatërron sistemet tona imunitare dhe kapacitetet tona për të rezistuar.⁶

⁴ Bashkim Selmani "Juridiksionet e veçanta në fushën e Terrorizmit. Studim krahasues Shqipëri-Maqedoni 2004/2005, Tetovë.

⁵ Jean Baudrillard "Articles ": a 129d date Publishet; 12. 7. 2004

⁶ Jean Baudrillard. Punim i cituar. është teoricien i njohur botëror. shkrimet e të cilit përqendrohen në ngritjen dhe rënien e shkëmbimit simbolik në periudhën bashkëkohore. Disa nga veprat e tij më të njohura janë Seduction, Simulacra and simulations, Symbollic Exchange

3. Loja ende nuk ka përfunduar ndërsa globalizimi nuk ka fituar plotësisht

Përkundër një fuqie të tillë shpërbërëse dhe homogjenizuese, forcat heterogjene - që jo vetëm se ndryshojnë, por haptas janë antagonistë - janë duke u zhvilluar çdokund. Prapa reagimeve të fuqishme ndaj globalizimit, që janë në rritje, si dhe formave sociale dhe politike të rezistencës ndaj globale, ne gjejmë diçka më shumë se sa shprehje të thjeshta nostalgjike të negacionit. Në vend të kësaj, ne gjejmë një revizionizëm shkatërrues vis-à-vis modernitetit dhe progresit, një përjashtim jo vetëm të tekno-strukturës globale, por po ashtu edhe të strukturës mentale të globalizimit, e cila nënkupton parimin e barazisë në mes të të gjitha kulturave. Ky lloj i reagimit mund të përfshijë disa aspekte të dhunshme, abnormale dhe iracionale, së paku ato mund të perceptohen si të dhunshme, abnormale dhe iracionale nga perspektiva e mënyrave tona tradicionale, të iluminuara, të të menduarit. Ky reagim mund të ketë forma kolektive etnike, religjioze dhe linguistike, por, gjithashtu, mund të ketë formën e shpërthimeve emocionale apo edhe të neurozave. Sidoqoftë, do të ishte gabim që t'i kritikojmë këto reagime thjesht si populiste, arkaike ose edhe terroriste. Në këto ditë, çdo gjë që posedon kualitetin e ngjarjes është e angazhuar kundër universalitetit abstrakt të globale⁷ dhe kjo, po ashtu, e përfshin kundërshtimin e Islamit ndaj vlerave të Perëndimit (sepse Islami është sfiduesi më i fuqishëm i këtyre vlerave dhe sot konsiderohet si armiku numër një i Perëndimit).

4. Dhuna strukturale dhe pasojat në shoqëri

Procesi i çrënjosjes së shkaqeve rrënjësore të luftës kërkon vënie në pyetje të strukturës ekonomike botërore, e ashtuquajtura dhunë strukturale. Gjithashtu kërkon konceptimin dhe planifikimin e një ekonomie globale të transformuar, e krijuar për të kapërcyer dhunën strukturale të varfërisë së imponuar. Edukimi për paqe mund të ndihmojë studentët të hetojnë në përhapjen e kapitalizmit korporativ (nëpërmjet

and Death, The Vital Illusion, The Spirit of Terrorism, The Singular Objects of Architecture, etj. François Debrix është asistent profesor i lëndës Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Universitetin Ndërkombëtar të Floridës në Miami, Floridë. Në bashkëpunim me Cynthia Weber ka edituar librin "Rituals of Mediation: International Politics and Social Meaning", botuar nga University of Minnesota Press, 2003. Artan Muhaxhiri është sociolog nga Kosova. Fushat e interesimit të tij përfshijnë sociologjinë e kulturës dhe humultimet sociale. Është redaktor ekzekutiv i revistës teorike "MM". (www.mm-ks.com)

⁷ "Contre cette universalité abstraite" në frengjisht. Së pari i botuar si "La Violence du Mondial", në Jean Baudrillard, Power Inferno (Paris: Galilée, 2002), f. 63-83.

korporatave) në epokën e globalizimit, duke vlerësuar pasojat e tij mbi mirëqenien e më të shtypurve e të prekshmëve, marginalizimin e pjesës më të madhe të popullsisë së botës, dhe shpërndarjen e padrejtë e të pabarabartë të përfitimeve të pasurisë së përfituar nga teknologjia moderne. Nxënësit adoleshentë dhe të rinj duhet të ekzaminojnë pasojat që pajja, demokracia, drejtësia ekonomike dhe të drejtat e njeriut vuajnë nga monopolet aktuale mbi teknologjinë dhe mund të veprojnë pasojat potenciale afatgjata të strukturave dhe dominimit korporativ mbi ekonominë botërore. Pasojat ekologjike të kontrollit të korporatave mbi burimet natyrore që ndikojnë potencialin e vendeve më pak të zhvilluara për të arritur zhvillim të qëndrueshëm janë një tjetër zonë thelbësore vëzhgimi për individët e rinj. Studentët duhen sfiduar që të mendojnë rreth kërcënimit se lufta mund të fillojë si shkak i shpërndarjes së padrejtë të burimeve të kufizuara ujore, dhe rreth faktit se si krizat e borxheve dhe politikat e zhvillimit kombëtar të drejtuara nga kërkesat e tregut do të ndikojnë në mundësitë e realizimit të një dinjiteti njerëzor dhe të një qëndrueshmërie ambientale e mjedisore planetare. Fushata Globale për Edukimin për Paqe synon të lehtësojë zhvillimin e burimeve dhe metodave për t'i paraqitur studentët me mënyra të menduari rreth këtyre problemeve që u përshtaten moshës së nxënësve. Edhe në klasat më të ulta, studentët mund të mësojnë rreth shkaqeve të dhunës dhe konflikteve dhe mund të inkurajohen që të gjejnë alternativa për këtë. Që prej etapave të hershme të zhvillimit të një fëmije, nocioni i një tendence të paevitueshme drejt armiqësisë dhe dhunës mund të vendoset në pyetje. Ndërsa studentët piqen, atyre mund tu mësohet për ndarjen midis të pasurve e të varfërve, dhe mund tu mësohet të hetojnë se si dhe pse këto pabarazira zhvillohen, dhe se si ato mbështeten dhe intensifikohen. Studentët mund të sfidohen jo vetëm që të njohin padrejtësinë strukturale, dhe të përgatiten për të krijuar struktura alternative, por edhe që të përfshihen në mënyrë aktive në realizimin e këtyre alternativave si qytetarë të përgjegjshëm të botës.

5. Mënyra e kryerjes së terrorit dhe dhunës dërkombëtare

Me terrorizmin dërkombëtar nënkuptojmë të gjitha aktet terroriste që kryhen nga kriminelët e shteteve të ndryshme, të cilat, në radhë të parë, kanë për qëllim shkatërrimin e të mirave materiale me interes të përgjithshëm. Ndryshe nga terrorizmi i shekullit të kaluar, ndërmarrë kryesisht prej ekstremistëve politik neomarksistë, apo neofashistë, që aksionet i zhvillonte në vendin e vet, në përpjekje për të destabilizuar

një qeveri, apo për të ndryshuar politikën e saj, tashmë, veprimet kryhen në të gjithë botën. Madje, edhe në distanca mijëra kilometra larg vatrave kryesore të tensionit. Aktet e dhunës ekstreme ndaj personave krejtësisht të pafajshëm e favorizojnë së tepërmi, kushtet e krijuara rishtazi në fusha të ndryshme. Terroristët po përdorin një rrjet gjithnjë e më global të mjeteve të komunikacionit; një treg gjithnjë e më ndërkom-bëtarë të veprimtarive ilegale, si shitjen e armëve, etj. një bazë gjithnjë e më të gjerë, që përbëhet nga emigrantë, të rregullt apo klandestinë, në vendet perëndimore; mundësinë e transferimit të fondeve e mjeteve monetare nëpër rrjetin modern të bankave, etj. Pra, ashtu sikurse është thënë në shumë raste, globalizmi, ky fenomen i pandalshëm, krahas të mirave, ka edhe të këqijat e veta. Edhe krimi terrori apo mafia, por edhe terrorizmi i kalojnë lehtësisht, kufijtë e një vendi të veçantë, duke e kthyer gjithnjë botën në fushën e operacioneve të tyre. Terroristët dhe kriminelët ndërkombëtarë kanë cilësi të përbashkëta. Ata janë të njoftuar mirë me të arriturat teknike të mjeteve të dhunës, centraleve kompjuterike, kartotekave etj. Sidomos me theks të veçantë kujdesen për regjistrat policore dhe të dhëna ndihmëse administrative.

Terroristët janë armiq të pushtetit. Ata kanë për qëllim të likuidojnë tërë pasurinë e shtetit, të ndërrojnë pushtetin dhe të luftojnë kapitalin e huaj. Taktika e tyre është shumë e shpërndarë. Nuk luftojnë në një front, por në koordinim dhe me përkrahjen e grupeve të ndryshme sulmojnë lloj-lloj caqesh të papritura. Ata i ndryshojnë sulmet, e befasojnë të sulmuarin, kundërshtarit kurrë nuk i japin shënime për grupin, mjetet, planet, gjurmët etj. Anëtarët e grupit shpërndahen nëpër vende të ndryshme. Në planet e tyre nuk marrin pjesë persona të panjohur. Aksionet i marrin deri në pesë veta. Shërbimi Qendror Informativ (CIA) i Shteteve të Bashkuara të Amerikës gjatë viteve 1968-1970 korporata terroriste edhe pse të ndaluara me deklarata universale dhe konventa tjera bëri 1152 akte terroriste ndërkombëtare, shumica e të cilave u kryen për shkaqe politike, interesa vetiake apo të grupeve. Kjo nënkupton se Mënyra e kryerjes së terrorit dhe akteve të dhunës ndërkombëtare gjithmonë ndërton kodin e veprimit shikuar nga aspekti i kodeve penale ndërkombëtare. Kriminelët ndërkombëtarë janë ata persona që sulmojnë një të mirë të siguar me të drejtën ndërkombëtare, ose ata që bëjnë krime ndërkombëtare.

6. Definimi i terrorit dhe terrorizmit ndërkombëtarë

Koha që po jetojmë dëshmon se në fillim mund të duket lehtë të dallohet një akt terrorist. Por, me gjithë ekzistencën e ligjeve dhe traktateve ndërkombëtare që e përkufizojnë terrorizmin si krim, është një fenomen i vjetër e cila është një metodë agresive për të arritur në qëllime të caktuara. Mirëpo, kjo metodë më tepër është përhapur gjatë disa dekadave të fundit, ku disa individ apo grupe, për të ushtuar presion ndaj qeverive, organeve ndërkombëtare apo grupeve të tjera të cilat shfrytëzojnë terrorin me qëllim arritjen në pushtet dhe në fuqi, ka mendimtarë dhe teoricienë që mendojnë ndryshe nga terrorizmi i shekullit të kaluar. Terrorizmi mund të përkufizohet si dhunë kryesisht kundër civilëve nga grupet që duan të ndikojnë tek politikat e një qeverie duke ngjallur frikë në shoqërinë e sajë. Analisti Brian Jackson i korporatë Rand në Uashington thotë se megjithëse objektivat e grupeve të veçanta terroriste mund të jenë të ndryshme nga njëri-tjetri, ka diçka të përbashkët që i lidh këto akte dhune. "Terrorizmi është armë psikologjike . Është përpjekje për të shkaktuar frikë dhe të ushtrojë ndikim tek të tjerët përmes frikës. Kështu duke u bërë keq pjesëtarëve të popullsisë, ata përpiqen të shkaktojnë frikë tek gjithë popullsia që ajo nga ana e saj të ushtrojë presion tek qeveria për të ndryshuar vendimet e saj", thotë analisti.⁸

Fjala terrorizëm do të thotë: dhunë e paramenduar ndaj masës jo luftuese me qëllim ndikimin e opinionit publik për të arritur më pas në goditjen e objektivave me natyrë politike, ushtarake apo ideologjike. Për rrjedhojë marrin kuptimet e tyre fjalët terrorist dhe terrorizoj. Terrorizmi konsiston në kryerjen e një krimi nga një individ, një grup apo nga një shtet. Terrorizmi përdoret për të ngjallur te njerëzit një ndjenjë frike e cila në shumë raste është shumë më e madhe se pasojat e vërteta të aktit. Këto akte kanë dy shënjestra, popullsinë ose dikasteret e rëndësishme të një shteti. Shkaqet e terrorizmit janë politike, për destabilizimin e një shoqërie por edhe për hakmarrje. Qëllime të ndryshme kanë çuar në themelimin e organizatave të ndryshme të cilat më pas nëpërmjet mesazheve të tyre me karakter politik ose fetar ngjallin frikë dhe panik në radhët e popullsisë.⁹

Ndër veçoritë kryesore të terrorit që atë e ndan nga llojet tjera të vrasjeve apo agresioneve, është krijimi i një atmosfere të tmerrshme dhe trishtuese, në mënyrë që në disa raste, terrori edhe më tepër se

⁸ News VOA com Zëri i Amerikës-Albanian "Informatika".

⁹ "Terrorizmi" nga Wikipedia, Enciklopedia e lirë f. 1.

vrasja e një apo më tepër individëve, krijon huti dhe tmerron një grup më të madh njerëzish. Si shembull patëm sulmet terroriste të 11 shtatorit në Amerikë, që u bënë shkak i trishtimit dhe frikësimit të të gjithë popullit amerikan, ku qeveria amerikane me anë të aparateve propagandistike e shtoi edhe më tepër këtë ndjenjë pasigurie tek populli i vet. Organizata dhe vende të ndryshme, me qëllim njohjen e fenomenit terrorizëm kanë dhënë një definicion i cili më tepër është i bazuar tek interesat dhe politikat e tyre personale. Por, sipas definicionit të OKB, terrorist konsiderohet çdo individ i cili duke frikësuar një person, qeverie apo një organizatë ndërkombëtare u imponon atyre kryerjen ose heqjen dorë nga një punë, apo në anën tjetër vret ose lëndon një person civil.¹⁰ Tentimin e parë për një definicion të tërësishëm e ka bërë autori me emrin *Hardman* në punimin e vet, me titull "*Enciklopedia e shkencave shoqërore*" në vitet e tridhjeta të këtij shekulli, ku terrorizmin e definon si metodë me të cilën një grup ose parti e organizuar tenton të realizoj qëllimet e veta, kryesisht përmes zbatimit të dhunës sistematike, duke e dalluar kështu terrorizmin jo vetëm nga terrori shtetëror, por edhe nga dhuna e turmës popullore apo nga kryengritjet masovike. Sipas tij aktet terroriste drejtohen kundër personave të cilët si njerëz, përfaqësues ose emisarë të pushtetit gjenden si një lloj pengese, në rrugë për arritjen e qëllimeve të parapara në programet e atij grupi ose partie të organizuar.¹¹ Në definicionet e lartshënuar dhe të OKB-së, edhe organizimi, zbatimi apo urdhri për kryerjen e një terrori, cilësohet terrorizëm. Edhe pse në këtë definicion aludohet më tepër në terrorizmin individual apo grupor (të organizuar), por duke pasur parasysh aspektet e gjëra që përfshin terrorizmi, vijmë në përfundim se edhe një shtet apo qeveri mund të kryejë akte terroriste, prandaj, shumë ide politike janë instrumentalizuar nga organizata terroriste për të justifikuar veprimet e tyre. Si rrjedhojë grupe terroriste ekzistojnë në çdo ideologji. Por një është e vërtet e pamohueshme dhe e argumentuar se në të gjitha kohërat Terrorizmi zakonisht ka në shënjestër civilët.

7. Terrorizmi si formë e udhëheqjes së luftës historiku dhe rrezikshmëria

Terrorizmi gjeneron frikësim psikologjik dhe forcë fizike në kundërshtim me ligjin, terrorizmi ka rrënjë të vjetra. Shembuj të terrorizmit janë sulmet e ndërmarra nga ekstremistët fetarë çifutë, të njohur me

¹⁰ "Terrorizmi shtetëror dhe mbrojtja legjitime" Internet. Informatika.

¹¹ Terrorizmi. Demolli Haki f. 6. Prishtinë, 2002 vit.

emrin *zelotët sikari*, kundër romakëve në Judenë e pushtuar si dhe në misionet martirizuese të hashashinëve (vrasësve) që kishin në shënjestër kryqtarët në Lindjen e Mesme. Të parët kanë vepruar gjatë 70 vjetëve të shekullit të 1-rë, kurse të dytët vazhduan mbi 200 vjet-nga shekulli 11-të, në të 13-të. Përvoja e tyre vërtetoi se terrorizmi mund të jetë tërheqës, efikas e i vazhdueshëm edhe kur mjetet janë pak a shumë primitive.

Në periudhat e mëpasme, duke filluar nga shekulli 16-të deri në vitet e fundit të shekullit të 18-të, disa shtete evropiane detare përdorën piratët, ose kusarët e detit, për të terrorizuar lundëtarët në dobi të arritjes së objektivave të politikës së jashtme. Gjatë Revolucionit Francez, në kohën e Sundimit të terrorit (1793-94), terrorizmi nga "lart" e nga "poshtë" ishte diçka e zakonshme. Një numër grupesh evropiane, të ushqyera me teori politike ekstremiste (p.sh. me ideologjitë majtiste e djathtiste) dhe me nacionalizmin militantist, arritën disa suksese taktik. Duke përdorur mbretvrasjen dhe veprimtari të tjera terroriste, si vënie bombash, terroristët vranë një numër të madh sundimtarësh evropianë, përfshirë carin Aleksandër II në vitin 1881. Vrasja e arkidukës austriak në Sarajevë i futi fuqitë në Luftën e Parë Botërore, megjithëse autori i saj nuk kishte pasur këtë qëllim. Edhe periudha midis dy luftërave botërore u karakterizua nga disa valë sulmesh në rajone të ndryshme të botës si Azia dhe Lindja e Mesme, ku grupet nacionaliste luftonin për t'u çliruar nga sundimi kolonial.¹²

Në njëqind vjetët e fundit, zhvillimet e vrullshme në teknologjitë moderne, përmirësimet në mjetet e komunikacionit dhe udhëtimet e shpejta e të pakushtueshme ndihmuan në përhapjen e grupeve indigjene terroriste me një forcë në rritje, dhe forma nga më të ndryshmet, në mënyrë dramatike, si për frekuencën dhe intensitetin e ngjarjeve terroriste, ashtu edhe për sasinë e dhunës së prodhuar, e shpërpjesëtuat në krahasim me mjetet e përdorura zakonisht. Dhe kjo edhe për shkak të një lloji *dyfishimi* të zonës terroriste, të përfaqësuar nga përdorimi në formë të *terrorit* të ushtruar drejtpërdrejtë ose në mënyrë të maskuar edhe nga shtet mendoni për "terrorin stalinian", ose atë të lëshuar nga bombardimet pa dallim si mbi Drezden, në Luftën e Dytë Botërore etj. Aq sa pranë me modelin e terrorizmit *kundër shtetit*, mund të vendoset një lloj tjetër, terrorizmi "i shtetit". Ajo që dikur ishte një fenomen i jashtëzakonshëm dhe jonormal, është sot pothuajse një element i jetës

¹² Yonan Alexander "Lufta kundër Terrorizmit" me parathënie nga R. James Woolsey ish-drejtor i CIA-S f. 16. Sh. L. Komunikimi.

së përditshme, i tillë sa duhet mbajtur parasysht deri edhe nga agjencitë e udhëtimit.¹³

Terrorizmi si formë e udhëheqjes së luftës dhe rrezikshmëria, para së gjithash, nuk mund t'u referohemi aspekteve të tipit ideologjik, por akoma më shumë rrethanave të lidhura me procesin e ndërtimit të shtetit. Pra mund të konludojmë se vet historiku i terrorizmit si formë e udhëheqjes së luftës dhe realizimit të qëllimeve qoftë e pushtetëmbajtësve apo grupeve terroriste është përdorur si si jetë dhe formë për qëllimet e caktuara kur nuk ka pasur mundësi dhe opsione tjera për të arritur deri te qëllimi. Shumë të mëdha kanë qenë transformimet e rrjedhura nga shpërbërja e perandorive të mëdha koloniale në të kaluarën veçanërisht britanike, franceze, gjermane, turke dhe ruse, e cila ka krijuar një ripërcaktim të hartës gjeopolitike të botës dhe ka bërë të lindin një numër i ri shtetesh.

Nuk është një rastësi që të gjitha perandorive të mëdha u është dashur të përballojnë emergjenca terroriste nga më dramatike dhe shkatërrimtare. Vlerësoj së po kështu, më 1816 menjëherë pas Kongresit të Vjenës shtetet sovraane në botë ishin vetëm 23, në 1919 pas Luftës së parë Botërore ishin bërë 49; në 1946 tashmë ishin 66, kurse në periudhën e përfshirë midis 1958 dhe 1964 dhe është dhëna më e jashtëzakonshme, numri i shteteve kaloi nga 90 në 122 sot në Kombet e Bashkuara përfaqësohen 182 shtete.¹⁴ Kështu pra, pothuajse kurrë nuk ka ndodhur që shumë modifikime të rëndësishme të bëheshin në mënyrë paqësore: pothuajse gjithmonë një luftë ka qenë e domosdoshme për suksesin e lëvizjeve për pavarësi dhe pothuajse çdo luftë është paraprirë nga një fazë e luftës terroriste. Vështrimi, analizimi dhe historiku i Terrorizmit dëshmojnë se terrorizmi gjithmonë është përdorur si version i fundit i suksesshëm për të arritur tek qëllimi qoftë si formë e udhëheqjes së luftës nga pushtete të ndryshme, individ apo grupacione, me pasoja fatale për njerëzimin, me theks të veçantë për civilët e pafajshëm. Terrorizmi i ditëve tona ka injektuar një shkallë të re dhune në jetën tonë bashkëkohore qoftë për sa i përket kërcënimeve, qoftë përgjigjeve ndaj tyre, çka na e bën të qartë se tashmë kemi hyrë në një "Epokë terrorizmi" me rrjedhoja serioze për sigurinë kombëtare, rajonale e globale. Rreziqet më të mëdha që burojnë nga terrorizmi i sotëm lidhen me sigurinë, mirëqenien dhe të drejtat e njerëzve të zakonshëm; me stabilitetin e sistemit shtetëror; me mbarëvajtjen e zhvillimit ekonomik;

¹³ Luigi Bonanate "Terrorizmi ndërkombëtar" f. 12. Erik 2001.

¹⁴ Po aty. Luigi Bonanate.

me zgjerimin e demokracisë; ndofta edhe me mbijetesën e vet qytetërimit.

8. Procesi evolutiv dhe galaktika e terrorizmit ndërkombëtar

Proceset evolutive dhe historia e përgjakshme e dhunës së terrorit thekson edhe një herë faktin se terrorizmi është një tipar i përhershëm i jetës ndërkombëtare dhe mishëron gjendjen e anarkisë në shoqëritë me theks të veçantë në shoqëritë e sotme, një gjendje që po kthehet në një makth të përgjithshëm. Ekzistojnë një sërë arsyesh të veçanta se përse terrorizmi do të shtohet në të ardhmen. *Së pari*, ai ka pasur shumë sukses në tërheqjen e vëmendjes publike, në prishjen e veprimtarive të qeverive e të bizneseve dhe në shkaktimin e një numri të konsiderueshëm viktimash njerëzore dhe dëmsh materiale. *Së dyti*, armët, lëndët shpërthyesë, furnizimet, financimet dhe komunikimet e fshehta mund të disponohen me lehtësi prej terroristëve. *Së treti*, ekziston një rrjet ndërkombëtarë që mbështet grupet dhe shtetet, çka e lehtëson shumë ndërmarrjen e veprimeve terroriste. Në këto kushte, nuk ekziston asnjë mbrojtje për segmentet e popullsisë civile ose për vendet që kanë lidhje të drejtpërdrejta me dhunën politike që nxitet nga konflikte të veçanta. Ka të ngjarë, pra, që superterrorizmi të shkaktojë në të ardhmen një efekt serioz dhe të pa precedentë në cilësinë e jetës dhe në ekzistencën e qytetëruar dhe të rregullt të njerëzve.¹⁵

Galaktika terroriste dhe rëndësia e terrorizmit ndërkombëtarë në histori është e tillë dhe është rritur shumë me kalimin e viteve, sa ekzistojnë tashmë në botë shumë institute të kërkimeve shkencore të kush-tuara për të studiuar vetëm këtë fenomen. Më shumë se 600 libra, artikuj dhe ese dedikuar terrorizmit janë publikuar gjatë 20 vjetëve të fundit Akorduar sipas Schmid, janë regjistruar 5831 tituj deri në vitin 1987. Biblioteka të tëra të specializuara grumbullojnë mijëra volume për të përshkruar dhe për të kërkuar të shpjegojnë natyrën, arsyet, justifikimet, reagimet ndaj terrorizmit, që mund të konsiderohet si një lloj alternative ose zëvendësim i luftës. Ashtu si kjo e fundit për të qenë e tillë, duhet të shpallet dhe të zhvillohet nga shtete dhe midis shteteve, kështu terrorizmi do të jetë arma e atij që ende nuk është, shtet, e atij që do të bëhet ose e atij që do të shkatërrojë shtetin ose rendin ndërkombëtar. Nga këto katër përcaktime të thjeshta rrjedh pra mundësia për të përcaktuar një

¹⁵ Yonan Alexander "Lufta kundër Terrorizmit" me parathënie nga R. James Woolsey ish-drejtor i CIA-S f. 20. Sh. L. Komunikimi.

fenomenologji të terrorizmit jashtëzakonisht të gjerë, që kërkojmë ta rikthejmë në drejtimit e tij themelore; terrorizmi si luftë për pavarësi; terrorizmi kundër shtetit *duke marrë parasysh afinitetet dhe ndryshimet me anarkizmin*; terrorizmi kundër rendit ndërkombëtar; terrorizmi si nxitje për destabilizimin e shoqërisë moderne.¹⁶

9. Galaktika terroriste me të vërtetë është e padepërtueshme?

Njëmijë ngjarje kanë tërhequr epitetin e terrorizmit, por, ato, a janë me të vërtetë të gjithë të ngjashëm? Më 1900 Gaetano Bresci vrau mbretin e Italisë Umberti I. Pasojat, për komunitetin ndërkombëtar, praktikisht janë zero. Katërmbëdhjetë më vonë, në 28 qershor 1914, Gavrilo Princip vrau në Sarajevë arkidukën Franz Josefin e Austrisë: është shkëndija nga e cila do të shpërthej Lufta e Parë Botërore. Të dy ngjarjet duken në thelb analoge: bëhet fjalë për një vrasje mbretërishe ose diçka e tillë, me origjinë dhe natyrë anarkike më shumë se çdo gjë tjetër; e megjithatë pasojat e të dy akteve janë tejet të ndryshme. Tjetër, më 1 mars 1881 lëvizja populiste ruse arriti të vranë carin Aleksandri II; në 22 nëntor 1963 një lëvizje klandestine, në realitet që ende dimë pak, vrau presidentin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës J. Kenedi. Jemi përballë dy ngjarjeve të ngjashme nga jashtë, ndërsa i pari kryhet nga një aspiratë popullore, megjithëse elita që sforcohet të zë rrënjë në shoqërinë ruse dhe të favorizojë kryengritjen, i dyti është rezultat i errët dhe i pakuptueshëm i një aksioni thjesht destabilizues, që s'nxjerr gjë në dritë si në planin politik ashtu dhe në atë shoqëror.¹⁷

Terrorizmi zotëron edhe një *virtyt* tjetër: kapacitetin e jashtëzakonshëm për të modifikuar format e pranisë së tij në shoqëri, të zhduket dhe të rishfaqet, si një feniks që vdes dhe rilind. Kështu është për terrorizmin irlandez, ky sigurisht me një kohëzgjatje më të madhe; por si për të mos mbetur të habitur përballë faktit që po ata ustashë, që në 1934 vranë mbretin Aleksandër të ish-Jugosllavisë, rilidhën fijet e lëvizjes *Dora e zezë* të shfaqur në Serbi përpara Luftës së Parë Botërore dhe që pikërisht në ditët tona u rishfaq në faqet alucinante të shkruara në tokat

¹⁶ Luigi Bonanate "Terrorizmi ndërkombëtar" f. 18. Terrorizmi ka logjikën dhe paradokset e tij. Veçanërisht ka njëmijë fytyra të errëta, p.sh. si ai i 22 nëntorit 1963 në Dallas, kur John F. Kennedy, bie viktimë e një atentati për të cilin ende dimë shumë pak. Një veprim që nuk arrin asnjë rezultat, as nga pikëpamja politike dhe aq më pak nga ajo shoqërore. Erik 2001.

¹⁷ Po aty, 18.

e ish-Jugosllavisë nga luftërat e *spastrimit etnik*. Indoktrinimi serbomadh i popullsisë serbe, për spastrimin e trojeve etnike shqiptare, ka qenë dhe është i pranishëm në çdo projekt serbomadh, gjë që dëshmon për një terrorizëm shtetëror ndaj shqiptarëve.

10. Funksionet nëpërmjet të së cilave realizohet terrorizmi ndërkombëtar dhe mënyra e veprimit të terroristëve

Funksionet nëpërmjet të së cilave realizohet terrorizmi ndërkombëtar janë instrumente me përdorim figurativ shumë të thjeshtë, sa aq edhe të komplikuar sa skandaloze aq edhe tronditëse. Në fakt, cili fenomen godet më shumë opinionin publik, që njih një raport midis mjeteve dhe qëllimeve edhe nga pikëpamja ekonomike aq të shpërpjesëtuar dhe fitimprurës, që nxit në të njëjtën mënyrë emocionet, që mund të demoralizojë tepër kundërshtarin, që mbjell panikun midis klasave të personave, nëse jo edhe banorëve të një metropoli si Londra që çdo ditë rrezikon të shohë një stacion të saj të hidhet në erë. Grupet terroriste bashkëkohore kanë përdorur një llojllojshmëri taktikash për të arritur qëllimet e tyre politike, shoqërore ose ekonomike. Metodatat më të përdorura kanë qenë vënia e zjarrit ndërtesave, vënia e bombave, rrëmbimet e njerëzve dhe mjeteve lëvizëse, sulmet kundër mjediseve në përdorim publik, shkatërrimi i pronave, vrasjet e njerëzve të zakonshëm dhe vrasjet e figurave politike. Arsenali i terroristëve përfshin jo vetëm lëndët plasëse dhe armët, si armët e zjarrit, por edhe mjete më të sofistikuar, si raketat antitank dhe raketat tokë-ajër. Megjithëse të gjithë terroristët karakterizohen nga e njëjta skemë e përgjithshme e veprimtarisë kriminale, mënyrat e veprimit dhe funksionet e tyre të veçanta ndryshojnë dukshëm në varësi të motivit dhe të aftësive të ç' do grupi. Grupet e vogla dhe jo të sofistikuar priren kryesisht për vënie bombash. Ato që gëzojnë mbështetjen e një shteti dhe pjesëtarët e të cilave zotërojnë aftësi më të mëdha përgjithësisht orvaten të kryejnë operacione më të ndërlikuara si rrëmbimi, e personash, vrasje figurash politike, sulme kundër mjediseve publike dhe rrëmbime mjetesh të lëvizshme.¹⁸

Ajo çka është veçanërisht shqetësuese ka të bëjë me faktin se në arenën e veprimeve terroriste po fillojnë të shfaqen “supermenët”. Me një fjalë, ndërkohë që zhvillimet teknologjike u ofrojnë grupeve

¹⁸ Yonan Alexander “Lufta kundër Terrorizmit” me parathënie nga R. James Woolsey ish-drejtor i CIA-S f. 18. Sh. L. Komunikimi.

terroriste aftësi të reja, edhe mënyrat e tyre të veprimit mund të ndryshojnë. Sipas raporteve të ndryshme të zbulimit, të paktën mbi dhjetë grupe terroriste kanë treguar interes për të shtëne në dorë armë biologjike, kimike ose bërthamore. Në vitin 1995, kur kulti japonez i “Ditës së Gjyqit të Madh” Aum Shinrikio sulmoi me gaz sarin një zonë të metrosë së Tokios nga i cili vdiqën dymbëdhjetë veta dhe u lënduan mbi pesë mijë të tjerë, udhëheqësit e tij të arrestuar thanë se po kërkonin armë më vdekjeprurëse se gazi sarin. Megjithatë, edhe pse gjatë katër dhjetëvjeçarëve të kaluar terroristët kanë arritur suksese taktike të ndjeshme, nganjëherë ata e shikojnë si politikisht më të leverdishme që ta ulin nivelin e dhunës politike. Por është e rëndësishme të kuptohet se këto kufizime të vullnetshme nuk do të vazhdojnë përgjithmonë dhe në të ardhmen incidentet do të vazhdojnë të shkaktojnë qoftë viktima në njerëz, qoftë shkatërrime të pasurisë materiale. Disa kushte të caktuara, si ekstremizmi fetar ose pikëpamjet se *kauza* e tyre ka pësuar humbje, mund t’i nxitin terroristët t’i përshkallëzojnë në mënyrë dramatike sulmet e tyre. Madje, incidentet terroriste në të ardhmen mund të jenë më shkatërrimtare në viktima njerëzore dhe në shkatërrime të pasurisë se në të kaluarën. Përdorimi i shkatërrimit në masë *biologjike, kimike ose bërthamore* si instrumente të terrorizmit mund të shkaktojë dëme të përmasave jashtëzakonisht të mëdha në njerëz e pasuri. Për shembull, megjithëse mundësia e terrorizmit bërthamor mbetet ende e vogël në krahasim me terrorizmin biologjik e kimik, pasojat e shkatërrimit në masë mund të jenë të pallogaritshme. Kështu, nëse një bombë me fuqi një kiloton një e njëzeta e fuqisë së bombës që u hodh mbi Hiroshimë vidhet ose ndërtohet nga një grup me burime e aftësi të mjaftueshme dhe shpërthen mbi një qytet të madh, ajo do të shkaktojë më shumë se njëqind mijë viktima si dhe dëmtime materiale që do të shkonin në miliarda dollarë. Pasojat njerëzore, fizike e psikologjike të një incidenti të tillë do të ishin shumë më katastrofike se ato të aksidenteve që ndodhën në Thri Mail Ajlënd ose në Çernobil dhe që u shkaktoan nga operatorët që, pa dashje, nuk zbatuan kërkesat e sigurimit teknik në sistemet e reaktorëve bërthamorë.¹⁹

Conclusion

Terrorism today is a serious international problem and therefore we can baptize it as the "era of international terrorism" existent that has

¹⁹ Po aty, f. 18.

never won the right seriousness nor by the politicians nor by the people who every day hear the refrain and threatened by terrorism. The large number of victims and caused damages in very large value, the public opinion every day hears the daily refrain as a grenade at the cafe, a electric mine in market, taking hostages, blowing institutional offices, a bomb left in a car, beating kidnapped, extortion and aircraft explosions, shocking appearance, where blood, fragmentation, burning, massive destruction, murdering of parliamentary officials, suicides of adults and children, trade with human beings and minors, all these as a result of criminal acts, are becoming a common scene, changes only where strikes are carried out and the number of victims, this proves that terror as a result of terrorist attacks and acts define this century as the world's most troubled and insecure so far to human society.

West is divided, Balkan is experiencing the terror of the border within four-year election separating from each other two electoral campaigns, make fatal mistakes each time wearing the wrong clothes terrorism, dedicating it to unrealistic reasons or giving it the face at will and instant need. Public with his daily refrain accuses wrong people, happens when governments follow wrong people. This situation recalls the time of the Black Death from which was cut off a third of the European population.

International terrorism was identified with the eleven September, Beslan and London today cannot only to disturb us. But the pain increases when you see separate bodies in middle and children weeping, enough on that human being will not be afraid when gets a bus, subway, to work or school, to leave for his beloved people and end the graveyard! Among others I believe that the causing elements of this situation of uncertainty that is prevails planet and accompanied many times by shocks such terror-setters is full of unknowns, harmful and dangerous to all mankind and we as a number of this community, with special impressions encourage us to be concerned with research of this disturbing phenomenon, this contemporary problem or "era of international terrorism " to approach with a major commitment and many years for radical notification for our honored students and readers, to elaborate the refrain of daily human, both at home and abroad.

Therefore we can conclude with this statement, the one who leaves righteousness and justice, in unrighteousness will stumble”.²⁰

NJËSITET POLICORE DHE SHËRBIMET TJERA QË ORGANIZOHEN NË PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E TERRORIZMIT

✚ **Brigadat sociale**-forcë speciale policore anti-anarkiste që ka vepruar në Spanjë

✚ **Burns**- agjencioni i vjetër i forcave të sigurimit i cili ka ndihmuar në luftën kundër terrorizmit.

✚ **BVSB-Brigade vor Speciale Beveiliging –Sopdrachten**, forcë speciale anti-terroriste, e rekrutuar nga policia ushttrake në Holandë;

✚ **DCDPP-Direzione Centrale Della Poliyia di Prevenzione** (Drejtoria Qendrore e Policisë për Prevencion), njësit policor që ndihmon luftën kundër terrorizmit në Itali;

✚ **Delta Force**, ekiye speciale të armatës kundër terrorizmit, të sajuara në vitin 1977 në SHBA;

✚ **DIGOS-Division for General Investigations and Special Operations** (Divizioni për Hetime Gjenerale dhe Veprime Speciale), njësit policor që ndihmon luftën kundër terrorizmit në Itali;

✚ **GIGN-National Gendarmerie Intervention Team** (Ekipi për Intervenim i Gjendarmërisë Kombëtare), njësit special në luftë kundër terrorizmit në Francë;

✚ **GSG-9-grenzschutz Gruppe-9** (Grupi-9 për Mbrojtjen e Kufinjëve), njësit i policisë speciale anti-terroriste, i sajuar në vitin 1972 në Gjermani,

✚ **HRT-Hostage Rescue Team** (Ekipi për Shpëtimin e Pengjeve), njësit i posaçëm i stërvitur mirë për shpëtimin e pengjeve dhe njerëzve të rrthuar, në SHBA;

✚ **LBT-Landelijke Bijstandsteam Terreurbestrijding**, njësit i policisë shtetërore i specializuar për mbledhjen dhe koordinimin e informatave lidhur me mbajtjen e pengjeve në Holandë;

✚ **Metropolitanos Police Speciale Branch** (Dega Speciale të Policisë Metropolitane), forcë speciale policore e Britanisë së Madhe për luftimin e kriminalitetit;

²⁰ Prof. Bashkim SELMANI, Ph. D. – quote from his university book „Crimonology and crime“ page 134, College “FAMA”, Pristina, 2015.

✚ **MI-5**-Securite Service (Shërbimi i Sigurimit), njësit që është përgjegjës për funksionimin kundërinformativ në Britani;

✚ **MI-6**- Secret Intelligence Service (Shërbimi Sekret Informativ), shërbim i policisë britaneye që kryen punët e shërbimit informativ jashtë venditë;

✚ **MOSAIDI**, Shërbimi sekret i Izraelit;

✚ **NOCS-Nucleo Operativo Centrale di Sicurezza** (Embrioni Kryesor Operativ për Siguri), njësit special në luftë kundër terrorizmit, i sajuar në vitin 1978, në Itali;

✚ **Pinkerton**, agjencioni i vjetër i forcave të sigurimit i cili ka ndihmuar në luftën kundër terrorizmit në SHBA;

✚ **Royal Air Force (Forca Ajrore Mbretërore)**, njësit ushtarak ajror i Britanisë së Madhe i cili angazhohet në luftë kundër terrorizmit;

✚ **Royal Navy (Marina Mretërore)**, forcë ushtarake e Britanisë së Madhe që angazhohet në luftë kundër terrorizmit;

✚ **RUC-Royal Ulster Constabulary (Policia Mretërore e Alsterit)**, që përbëhet kryesisht nga policët protestantë (90%) dhe vepron në Irlandën e Veriore;

✚ **SAS-Special Air Services (Shërbimet Speciale Ajrore)** ekipet antiterroriste të Britanisë së Madhe;

✚ **Scotland Yards Anti-terrorist Branch C-13 (Dega C-13 Anti terroriste e Skotland Jardt)**, njësit special policor për luftimin e terrorizmit i sajuar në Britaninë e Madhe;

✚ **SERT-Special Emergency Response Team** (Ekipi Special për Reagim Emergjent), njësit special kundër terrorizmit që vepron në Kanadë;

✚ **Special Branch Squads (Ekipet e degës Speciale)**, forcë speciale policore për luftë kundër terrorizmit, e sajuar në vitin 1961 në Britaninë e Madhe;

✚ **Squadro Anti-Commando (Skuadra Anti Komandosë)**, vepron kundër terrorizmit në Itali;

✚ **SAT-Special eapons and Tactic Teams** (Armët Speciale dhe Ekipet taktike), njësit special në luftën kundër terrorizmit në SHBA;

✚ **TASK Force 160**, njësit special në luftë kundër terrorizmit në SHBA;

✚ **TE**, njësit policor i themeluar në vitin 1975 nga Biroja Federale Kriminalistike e Gjermanisë i cili merret me luftimin e terrorizmit;

✚ **TREVI-Terrorism Radikalism Ekstrem Violence International (Terrorizëm, Radikalizëm, Dhuna Ekstreme Ndërkombëtare)**, është grup ndërkombëtar i themeluar nga disa shtete për luftë kundër terrorizmit;

✚ **ULCAT (Unite de Coordination por la Lutte Anti-terrorist)**, (Njësitet për Koordinimin e Luftës Anti-terroriste), njësit special për luftë kundër terrorizmit në Francë.

BIBLIOGRAFIA

1. Altin Shegani, *Les Juridictions d'Exception en matiere de Terrorisme, Etude Franco – Albaanise* , Universite Montesquieu – Bordeaux IV , Bordeaux, 2002.
2. Bashkim Dr. Selmani “*Krimi i organizuar dhe terrorizmi ndërkombëtar*”-Universiteti pare privat “FON”-Shkup , 2009.
3. Bashkim Dr. Selmani & Mevledin Dr. Mustafi “*Sistemet e sigurisë-Sisteme security*”-Shtëpia botuese “Furkan”-Shkup, 20016.
4. Alexandar, Yonah. “*Terrorizmi i Lindjes së Mesme*”. Profile grupesh të Përzgjedhura Middle East Terrorism. Selected Group Profiles. Uashington, D. C. , Instituti Çifutët për Çështjet e Sigurisë Kombëtare 1994.
5. Alexandar, Yonah, Mishael S. Setman dhe Herbert M. Levine, red. , ETA: Profili i një grupi. Transnational, 2001.
6. Bashkim Dr. Selmani & Mevledin Dr. Mustafi “*Sistemet e sigurisë-Sisteme security*”-Shtëpia botuese “Furkan”-Shkup, 20016.
7. A. Bracci: “Što se mjenja yakonom o antiterorizmu”, Izbor nr. 3. Zagreb, 1980
8. Ali Hadri “The position and condition of Kosova in the Kingdom of Jugoslavija 1918-1941, The truth on Kosova , Tirane.
9. Bashkim Selmani “*Juridiksionet e veçanta në fushën e Terrorizmit. Studim krahasues Shqipërië-Maqedoni 2004-2005*, Tetovë
10. Abdul Haj El-Husein El-Fermavi në Gjak në Flakë përkthen Rexhep Nuredini, Shkup 1993 .
11. Aggarala Narinden, Political Aspect of Hijacking, International Concilation, November 1971. , Nr. 585.
12. Allen Francais, The Crimes of Politics:Political Dimension of Criminal Justice, Cambridge, 1974.

13. Avramov Smilja, Medjunarodno Javno pravo, Beograd, 1973. , 1976. dhe 1978.
14. Arond Raymond, Paix et Guere entre les nations 6E edition revue et corrige, Paris 1968.
15. Abdurrahman Hasan Hanbekete El-Mejdani, El-Ahlak'ul-islamijetu ëe ususuha, pjesa I, botimi VI, Damask, 1423 h. 2003.
16. Alibek, Ken. Reziku Biologjik; Historia Rrëqethëse e Programit më të Fshehtë e më të
17. Madh të Armëve Biologjike në Botë sipas Pohimit Konfidencial të Njeriut që e Drejtoi atë The Chilling Story of the lagest Covert Biologica eapons Program in the olrd,
18. Told from the Inside by the Man ho Ran it Nju Jork:Random House, 1999.
19. Alex P. Schmid: "Political terorism", Amsterdam-Holand, 1983.
20. Andrija Makra: "Suvremeni terorizam ", "13 Maj nr. 6, Beograd, 1979. "
21. Abdulkerim Zejdan, Individi dhe shteti në sheriatin islam, Prizren, 2000.
22. Aleksiq Zh. "Strategija policije protiv terorizma", "Intervju"nr. 18/1982 Beograd.
23. Armand Mergen : "Uvidija kao kljuc uspjeha", Izbor nr. 1. Zagreb, 1989.
24. Allain Labrousse, The Tupamaros, Harmonosoth 1973.
25. Ali Tariq, Nev Revolutionaries, Neyork 1969.
26. Alehauder J. And Finger S. M. -Terrorism; Interdisciplinary Perspe ctives, Ne York, 1969.
27. Amos Perlmuter: "The Izrael- PLO accord is dead" Foreign Affarirs Vol. 74. nr. 7. USA. 1995.
28. Ali Bajgora: "Krimet kundër lirive dhe të drejtave të njeriut në Kosovë", Prishtinë, 1998.
29. Bashkim Selmani "Juridiksionet e veçanta në fushën e Terrorizmit. Studim krahasues Shqipërië-Maqedoni 2004-2005, Tetovë
30. Beckith, Charlie A. Delta Fors: Njësi Kryesor Antiterrorist i Ushtrisë (Delta Force: The Army's Elite Counterterroist Unit), Nju Jork: Avon, 2000.
31. Bell Boyer J. Dinamika e Luftës së Armatosur (The Dynamics of the Armed Struggle), londër: Frank Cass, 1998.

32. Cohen, Susan, dhe Daniel Cohen. Avioni Pan Am 103: Bombardimi, Tradhtitë dhe Kërkimi i Drejtësisë nga Familjet në Zi. (Pan Am 103: The Numbing, the Betrayals, and a Bereaved Family's Search for Justice. Nju Jork: Signet, 2001.)

33. Cooley, John K. Luftërat jo të shenjta: Afganistani, Amerika dhe Terrorizmi Ndërkombëtar. (Unholy wars: Afghanistan, America, and International Terrorism). Londër: Pluto Press, 1999.